

20260300434

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT E REGJISTRIT TË
VEÇANTË PËR PERSONA TË DËNUAR ME AKTGJYKIM TË PLOTFUQISHËM PËR
VEPRA PENALE PËR KEQPËRDORIM SEKSUAL TË PERSONAVE TË MITUR DHE
PEDOFILI**

Neni 1

Në Ligjin e Regjistrit të Veçantë për Persona të Dënuar me Aktgjykim të Plotfuqishëm për Vepra Penale për Keqpërdorim Seksual të Personave të Mitur dhe Pedofili (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 11/12 dhe 112/14), në titull fjalët “personave të mitur” zëvendësohen me fjalën “fëmijëve”.

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si vijon:

“Regjistri përmban të dhëna për persona të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për vepra penale kundër lirisë seksuale dhe moralit seksual të kryera ndaj fëmijëve:

- 1) sulmi seksual dhe dhunimi (neni 186, paragrafi 2 i Kodit Penal);
- 2) keqpërdorimi seksual i personit të dobët (neni 187, paragrafi 2 i Kodit Penal);
- 3) dhunimi i fëmijës nën moshën 15 vjeçare (neni 188 i Kodit Penal);
- 4) tradhtia bashkëshortore me keqpërdorim të pozitës (neni 189, paragrafi 2 i Kodit Penal);
- 5) plotësimi i pasioneve seksuale para tjetrit (neni 190, paragrafët 2 dhe 3 të Kodit Penal);
- 6) ngacmimi seksual (190-a i Kodit Penal);
- 7) shfaqja e materialit pornografik të një fëmijë (neni 193 i Kodit Penal);
- 8) prodhimi dhe shpërndarja e pornografisë për fëmijë (neni 193-a i Kodit Penal);
- 9) joshja për tradhti bashkëshortore ose akt tjetër seksual i fëmijës nën moshën 14 vjeçare (neni 193 i Kodit Penal);
- 10) përdhosje gjinore (neni 194, paragrafi 2 i Kodit Penal
- 11) trafikimi i fëmijëve (418-g i Kodit Penal).”.

Neni 3

Në nenin 5, pikat 1 dhe 2, fjalët

“Ministria e Punës dhe Politikës Sociale përmes” fshihen.

Neni 4

Në nenin 6-a, në paragrafin 1, fjalët: “Drejtoria e Ekzekutimit të Sanksioneve” zëvendësohen me fjalët “Institucioni Ndëshkues Përmirësues” dhe fjalët “IP Enti i veprimtarive sociale” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Drejtësisë - Drejtoria e Ekzekutimit të Sanksioneve”.

Pas paragrafit 1, shtohen dy paragrafë të rinj 2 dhe 3, si vijojnë:

“Ministria e Drejtësisë – Drejtoria e Ekzekutimit të Sanksioneve është e detyruar në afat prej 15 ditësh pune nga dita e dorëzimit, kopjen e aktgjykimit të formës së prerë me të cilin personi është dënuar për veprën penale nga neni 3 i këtij ligji, si dhe njoftimin me shkrim nga paragrafi 1 i këtij neni, t’i dorëzojë NP Entit të Veprimtarive Sociale - Shkup.

Organi kompetent për mbajtjen e Regjistrit të veçantë është i detyruar të paktën një herë në vit të kontrollojë dhe harmonizojë të dhënat e futura me të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe për mospërputhjet e përcaktuara të marrë menjëherë masa për eliminimin e tyre.”.

Neni 5

Në nenin 6-a, në paragrafin 2 fjalët: “dhe ndryshohet në çdo dhjet vjet” shlyhen.

Neni 6

Në nenin 7, në paragrafin 2, fjalët: "Ministria e Drejtësisë nëpërmjet Drejtorisë së Ekzekutimit të Sankcioneve është e detyruar" zëvendësohen me fjalët: "Institucioni ndëshkuese përmirësuese është i detyruar".

Në paragrafin 4, fjalët: "Ministria e Punës dhe Politikës Sociale përkatësisht" shlyhen.

Neni 7

Në nenin 13, fjalët "Ministria e Punës dhe Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalët: "Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe e të Rinjve".

Neni 8

Në të gjithë tekstin e ligjit fjalët: "të mitur" zëvendësohen me fjalën "fëmijë" dhe fjalët: "i mitur" zëvendësohen me fjalën "fëmijë".

Neni 9

Në Regjistrin e Posaçëm për personat e dënuar me aktgjykim të formës së prerë për veprat penale të abuzimit seksual të të miturve dhe pedofilisë, të dhënat regjistrohen edhe për personat e dënuar me aktgjykim të formës së prerë për veprat penale të përcaktuara në nenin 3 të Ligjit të Regjistrimit të Veçantë për Persona të Dënuar me Aktgjykim të Plotfuqishëm për Vepra Penale për Keqpërdorim Seksual të Personave të Mitur dhe Pedofili (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 11/12 dhe 112/14).

Neni 10

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të caktojë tekst të konsoliduar të Ligjit të Regjistrimit të Veçantë për Persona të Dënuar me Aktgjykim të Plotfuqishëm për Vepra Penale për Keqpërdorim Seksual të Personave të Mitur dhe Pedofili.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.